



E martë, 24 qershor 2014

NJOFTIM PËR MEDIA

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në takimin e tij të gjashtë të mbajtur sot me 24 qershor 2014, ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbledhen nga Furnizuesi Publik nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.

Në marrjen e vendimit për të Hyrat e Lejuara Maksimale, që do të mbulojnë nga Furnizuesi Publik, ZRRE ka analizuar në detaje të gjitha kostot e sistemit të energjisë elektrike. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulojnë kostot për furnizim të publikut me energji elektrike për vitin tarifor 2014 janë 239,965,097 euro.

Kjo do të thotë se Furnizuesi Publik varësisht nga konsumi i parashikuar për kategori të ndryshme të konsumatorëve do të mbledhë përmes tarifave shumë prej 239,965,097 euro, e cila i mbulon të gjitha kostot e gjenerimit, transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit të Energjisë Elektrike deri tek konsumatorët fundor.

ZRRE këtë vit ka lejuar me pak kosto në krahasim me vitin e kaluar, duke pasur parasysh se kostot e sistemit vitin e kaluar kanë arritur në vlerë prej 242.5 mil euro. Mirëpo për shkak të kursimeve gjatë vitit 2012, prej 17.9 milion Euro, Furnizuesi Publik është lejuar të mbledhë vetëm të Hyrat e Lejuara Maksimale në vlerë prej 224.6.

Për shkak të kompleksitetit të procesit tarifor, duhet të theksohet se Vendimi për MAR nuk parqet Vendim për ndryshimin e tarifave me pakicë të konsumatorëve fundor. Ky Vendim i përcakton të hyrat maksimale dhe në bazë të konsumit të parashikuar të Energjisë Elektrike nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve Furnizuesi Publik duhet t'i përgatis dhe dorëzoj ZRRE-së propozimin për aprovim të tarifës së rregulluar me pakicë, brenda një afati sa më të shkurtë.

Vlerat e sakta të tarifave me pakicë do të jenë të njohura vetëm pas aprovimit nga Bordi i ZRRE-së, pasi të kryhet analiza e parashikimeve për konsum në secilën kategori të konsumatorëve dhe në kohën e atij konsumi.